

STATUTI

SHOQËRISE TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

“Saranda Vacations” SH.P.K

Bazuar në ligjin 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar nëpërmjet Ligjit 129/2014 datë 02.10.2014, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë fushën e rregjistrimit, liçensimit dhe funksionimit të subjekteve tregtare në Republikën e Shqipërisë, në Elbasan, sot, më datë 18.05.2023, subjekti juridik, shoqëria tregtare “Balkan Peninsula Enterprise” sh.p.k e rregjistruar në QKB me NIPT: M32820202K me adresë Lagja 11 Nentori, Zona kadastrale 8525, me numer pasurie 10/193-ND.3 lloji njesi, Elbasan, Shqipëri, përfaqësuar nga administratori i saj Kejvin Kalo mbajtës i ID: J50109056H, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar dhe unë Ledjon Agalliu i biri i Idajet, lindur në Berat, më 18.11.1992 dhe banues në Berat, shtetas Shqiptar, mbajtës i ID: J21118055U, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar; me vullnetin tonë të lirë, në cilësinë e ortakëve themelues, pasi themeluam shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Saranda Vacations” sh.p.k shpallim statutin e shoqërisë tregtare si më poshtë vijon:

FORMIMI

Neni 1


Formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “Saranda Vacations” sh.p.k me dy ortakët e mëposhtëm themelues:

- Shoqëria “Balkan Peninsula Enterprise” sh.p.k e rregjistruar në QKB me NIPT: M32820202K,
- Ledjon Agalliu i biri i Idajet, lindur në Berat, më 18.11.1992 dhe banues në Berat, shtetas Shqiptar, mbajtës i ID: J21118055U,

Neni 2

Selia kryesore e shoqërisë tregtare “Saranda Vacations” sh.p.k shoqëri me përgjegjësi të kufizuar është në Lagja 11 Nentori, Zona kadastrale 8525, me numer pasurie 10/193-ND.3 lloji njesi, Elbasan, Shqipëri.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe në cdo shtet tjetër të huaj, me miratimin e asamblesë së përgjithshme të ortakëve dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku do ta ushtrojë këtë veprimtari, duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë e saj.



Shoqëria mund të hapë edhe vend qëndrime të tjera si filiale, përfaqësi, agjensi, degë, etj. në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në çdo shtet tjetër të huaj, me miratim të asamblesë së përgjithshme dhe në përputhje me dispozitat ligjore të vendit apo shtetit përkatës ku ato do të hapen.

Shoqëria mund të shtojë/pakësojë numrin e ortakëve duke ndryshuar në këtë mënyrë numrin e kuotave dhe të ortakëve, si dhe pjesëmarrjen e tyre në kuotat e shoqërisë. Për këtë arsye për të parashikuar mënyrën e funksionimit në rastet e shtimit të ortakëve në këtë statut janë përfshirë disa klauzola të përgjithshme që garantojnë funksionimin normal në periudha tranzitore. Në rast të shtimit/pakësimit të numrit të ortakëve dhe shndërrimit të shoqërisë nga shoqëri me shumë ortakë në shoqëri me një ortak, do të depozitohen ndryshimet në QKR dhe do të specifikohen klauzolat e statutit në përputhje me situatat e reja të krijuara.

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga shtimi i numrit të ortakëve asambleja e ortakëve në mbledhje të jashtëzakonshme të saj do të vendosë për ndryshime eventuale të organeve drejtuese, administratorit dhe statutit të shoqërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë tregtare “Saranda Vacations” sh.p.k është e pacaktuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare “Saranda Vacations” sh.p.k është:

- 1- Hoteleri, Bar-Restorant, SPA, Sherbime Turistike, Beach – Bar.
- 2- Veç sa më sipër në shoqëri do të zhvillohet çdo aktivitet tjetër që vetëm ose së bashku me veprimtarinë kryesore të lartpërmendur, do të vlerësohen si të favorshme për zhvillimin, forcimin dhe rritjen e gjendjes ekonomike e financiare të saj.

Neni 5

Shoqëria tregtare mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Përgjithshme.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themelor i shoqërise është caktuar në shumën 10.000 lekë dhe përbëhet nga 2 kuota me vlerë nominale totale së bashku prej 10.000 lekë.

Kapitali themelor, kontribuohet prej ortakëve themelues, u takon ortakëve atyre, dhe është i ndarë si më poshtë:

- Ortaku, Shoqëria “Balkan Peninsula Enterprise” sh.p.k e rregjistruar në QKB me NIPT: M32820202K, posedon 1 kuotë me vlerë nominale 8.000 lekë, me përqindje pjesmarrje në shoqeri prej 80% te kuotave të kapitalit të saj,
- Ortaku, Ledjon Agalliu i biri i Idajet, lindur në Berat, më 18.11.1992 dhe banues në Berat, shtetas Shqiptar, mbajtës i ID: J21118055U, posedon 1 kuotë me vlerë nominale 2.000 lekë, me përqindje pjesmarrje në shoqeri prej 20% te kuotave të kapitalit të saj.

Ortakët e shoqërisë do të derdhin në llogaritë bankare të saj, shumën e përcaktuar më sipër, brenda 90 ditëve nga data e rregjistrimit të shoqërisë në rregjistrin tregtar pranë QKB.

Neni 7

Vendimet e asamblese do të quhen të vlefshme vetëm në rastet kur ato do të jenë në përputhje të plotë me percaktimet e ligjit ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, dhe për të gjitha rastet e trajtuara në mënyrë eksplicite në statutin e shoqërisë, vendimet do të quhen të vlefshme vetëm në rastet kur ato do të jenë në përputhje të plotë me percaktimet e bëra në statutin e shoqërisë i cili është në fuqi në momentin e vendimarrjes.

Kapitali i shoqërisë tregtare mund të shtohet ose pakësohet sipas vendimeve që do të marrin organet drejtuese të shoqërise, duke i miratuar keto vendime në mënyrë unanime me 100% të të gjithë kuotave të shoqërisë. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themelor (rritjen e ketij kapitali nëpërmjet kontributeve të tjera).

Pjesët e kapitalit të çdo ortaku janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Pjesët e kapitalit që zotërohen nga secili prej ortakëve, nuk mund të tranferohen nëpërmjet akteve ligjore në persona të tjerë jashtë ortakëve të shoqërisë, përveçse midis ortakëve të saj, midis familjarëve të radhës së parë të këtyre ortakëve apo midis trashëgimtarëve të këtyre ortakëve, sipas përcaktimeve të Kodit Civil.



Në rastin kërkesës së largimit të ndonjërit prej ortakëve, kërkesa e tij do të shqyrtohet nga asambleja brenda periudhave të parashikuara nga ligji 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe pas kalimit të këtyre afateve, kjo kërkesë do të konsiderohet e miratuar nga asambleja e shoqërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit, në rastin kërkesës së largimit të ndonjërit prej ortakëve, do të bëhet duke u vlerësuar pjesa përkatëse e kapitalit të tij, me vlerën nominale të kuotës të paraqitur në pasqyrat financiare të shoqërisë në periudhën vjetore paraardhëse, në postin e kapitaleve të veta të shoqërisë, dhe kjo shumë do të likujdohet me tre këste të barabarta brenda një periudhe jo më të gjatë se tre vjecare nga data e marrjes së vendimit për largimin e ortakut.

Shoqëria detyrohet ti likujdojë kuotën ortakut që do të largohet, dhe kuota e tij do të kalojë në favor të ortakëve të tjerë të shoqërisë.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Organi më i lartë i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, ajo përbëhet prej ortakut/ortakëve të shoqërisë.

Asambleja është organi sovran i shoqërisë duke u mbështetur në të drejtën e tyre të pronësisë private mbi mjetet e investuara në shoqëri. Asambleja e Përgjithshme thirret dhe merr vendime të vlefshme sipas mënyrës së përcaktuar në dispozitat e ligjit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Asambleja e Përgjithshme përcakton dhe miraton të drejtat dhe detyrat e organeve të saj. Të zgjedhurit dhe të emëruarit nga Asambleja veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij statuti, aktit të themelimit si dhe ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Vendimet që merr Asambleja sipas këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi janë të detyrueshme për cdo ortak. Secili ortak ka të drejtë vote sipas përqindjes në kuotën e kapitalit themelues të shoqërisë.

Për cdo ceshtje të shqyrtuar nga ortakët mbahet procesverbal në një regjistër të vecantë. Asambleja zhvillon mbledhje të zakonëshme dhe të jashtëzakonëshme. Ajo thirret jo më pak se dy herë në vit. Në mbledhje të jashtëzakonëshme shqyrtohen dhe vendosen probleme që kanë të bëjnë me krijimin, bashkimin, ndarjen, shpërndarjen, ndryshimin e statutit e probleme të tjera të rëndësishme për të cilat kërkohet miratimi i përbashkët nga ortaku/ortakët themelues.

Neni 9

Secili ortak që ka të drejtën e pjesëmarrjes në Asamble dhe mund të përfaqësohet në të edhe nga një person tjetër i autorizuar me shkrim nga ortaku i shoqërisë.



Neni 10

Asambleja e Pergjithshme e shoqërisë tregtare “**Saranda Vacations**” sh.p.k drejtohet nga ortaku prezent në mbledhje që ka kuotën e pjesmarrjes më të madhe në vendimerrjen sipas statutit të shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria tregtare “**Saranda Vacations**” sh.p.k deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të legjislacionit shqiptar, të statutit, aktit të themelimit.

Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj si person juridik në Rregjistrin Tregëtar pranë QKB.

Administrator i Shoqërisë është Znj. Griselda Kodra me ID: J65718111T. Afati i emërimit në detyrë të administratorit është 5 vjet me të drejtë riemërimi. Ky afat fillon nga 18.05.2023 deri më 17.05.2028.

Neni 12

Shoqëria do të ketë vulën e saj me përmbajtjen: “**Saranda Vacations**” sh.p.k & Nr NUIS. Emri tregtar i shoqërisë do të jetë: **Lux’Me Suites**.

Shoqëria do të ketë llogaritë e saj bankare në lekë e valutë në Banka të cilat operojnë në Shqipëri, si dhe në Banka të cilat operojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Shoqëria tregtare “**Saranda Vacations**” sh.p.k vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër vetëm të drejta dhe detyrime kontraktuale dhe jo kontraktuale brënda kapitalit të saj. Ortaku/Ortakët e shoqërisë mbartin rrezikun për rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë në nivelin e kapitalit themelor të shoqërisë duke mos u përgjigjur në asnjë rast, me pasuritë vetjake të realizuara në veprimtari të tjera ekonomike për detyrimet e kësaj shoqërie.

Neni 14

Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, Asambleja emëron organe kontrolli si dhe punëson persona të tjerë të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa kërkohen nga Asambleja ose largohen me dëshirën e tyre.

Vetëm me miratimin me shkrim të Asamblesë së ortakëve, administratori ka të drejtë të negociojë dhe të nënshkruajë akte ligjore, për të marrë apo dhënë hua, në raport me palë të treta.

Administratorit me perjashtim të rastit kur është ortak i vetem dhe administrator, nuk i lejohej të kontrakttojë në çfarëdo forme, të marrë apo të japë hua, qoftë të marrë hua në shoqëri të tjera, të japë pëlqimin në emër të shoqërisë për paradhënie e të bëhet dorëzanës apo të garantojë në emër të saj ndaj të tretëve.



Marrëdhëniet financiare midis shoqërisë dhe ortakëve të saj, do të realizohen sipas nevojave reciproke dhe brenda mundësive financiare të shoqërisë, pa u penguar nga administrimi i saj, dhe nuk do të trajtohen në asnjë rast si huamarrje apo huadhënie midis shoqërisë dhe ortakëve të saj, për të cilat do të nevojitej një vendim i Asamblesë së ortakëve përpara ekzekutimit të transaksioneve, por do të evidentohen në çdo rast në llogaritë financiare të shoqërisë në postin e të arkëtueshme apo të pagueshme, dhe do të jenë subjekt i vlerësimit dhe i vendimarrjes në mbledhjen e Asamblesë për miratimin e pasqyrave financiare të vitit përkatës paraardhës.

Neni 15

Administratori merret me drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa kufizime. Administratori ka për detyrë të njoftojë e të japë llogari në Asamblenë e Ortakëve me përjashtim të rastit kur është ortak i vetëm dhe administrator dhe si i tillë i mbart vetë këto cilësi.

Neni 16

Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, Asambleja e përgjithshme nëpërmjet këtij statuti ka dhënë pëlqimin që vetëm në rastin kur shoqëria ka një ortak të vetëm i cili është edhe administrator i saj, të lejohet marrja hua prej ortakut të vetëm të saj, ndërsa për çdo rast tjetër, kjo e drejtë duhet të miratohet me një vendim përkatës të Asamblesë së përgjithshme.

Kapitali i shoqërisë është lirisht i transferueshëm prej trashëgimtarëve të cdo ortaku në rast vdekjeje.

MARDHËNIET E PUNËS

Neni 17

Mardhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës duke zbatuar legjislacionin shqiptar. Shoqëria merr përsipër që të respektojë rregullat në fuqi të punësimit, ndërsa të punësuarit janë të detyruar të pranojnë këtë statut dhe cdo akt që rregullon veprimtarinë e shoqërisë.

Neni 18

Të punësuarit në shoqëri përgjigjen sipas ligjit dhe sipas statutit. Për mos zbatimet dhe dëmet që mund t'i shkaktojnë shoqërisë mbajnë përgjegjësi administrative, disiplinore e penale. Mosmarrëveshjet, që mund të lindin midis të punësuarve dhe punëdhënësit kur nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, secila palë ka të drejtë që t'i drejtohet organeve të drejtësisë.



Neni 19

Punonjësit e emëruar apo të punësuar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit që realizon shoqëria në veprimtarinë e saj ekonomike, nëse kontrata e punës nuk është e parashikuar ndryshe.

Të gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës në shoqëri. Kjo është e detyrueshme dhe pas largimit nga puna e tyre.

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Neni 20

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “Saranda Vacations” sh.p.k i takon Administratorit të saj të emëruar në periudhën korrente përkatëse. Ai ka të drejtë që të përfaqësojë shoqërinë në organet gjyqësore, të caktojë e pajtojë avokat kur është e nevojshme.

Neni 21

Shoqëria organizon kontrollin e brendshëm me ekspert kontabël të emëruar me ose pa afat. Ekspertët kontabël kontrollojnë e garantojnë që llogaritë vjetore të jenë të rregullta, të besueshme për rezultatin dhe gjendjen financiare. Ata kontrollojnë mbajtjen dhe evidentimin e veprimtarive financiare në përshtatje me ligjin dhe aktet e tjera për kontabilitetin. Ata janë përgjegjës ndaj shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat që rrjedhin nga fajet apo paaftësitë e tyre në kryerjen e detyrës.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 22

Veprimtaritë ekonomike dhe financiare të shoqërisë mbyllen në 31 Dhjetor të cdo viti. Administratori i shoqërisë nxjerr bilancin kontabël dhe raportin përkatës në përputhje me dispozitën ligjore për kontabilitetin.


Raporti i administrimit, inventarët, bilancet dhe llogaritë vjetore të hartuara i nënshtrohen pa përjashtim miratimit nga Asambleja e ortakëve (apo ortaku i vetëm nëse do të jetë në kushte të tilla) brenda afateve të caktuara.

Me miratimin e bilancit kontabël shoqëria vendos për fondet e nevojshme për zhvillimin si p.sh: fondi rezervë, atë te akumulimit, investimit etj.

Neni 23

Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve si më sipër dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale i mbeten për përdorim ortakëve të shoqërisë të cilët i ndajnë midis tyre për cdo vit ushtrimor, si më poshtë:

- 1- 50% të fitimeve neto pas tatimit, të secilit vit ushtrimor do të shpërndahen si dividend tek ortakët e shoqërisë, në raport me kuotat përkatëse të pjesmarrjes së tyre, dhe,



2- 50% të fitimeve neto pas tatimit do të caktohen në përputhje me vendimin e Asamblesë së ortakëve për caktimin e këtyre fitimeve.

Vendimi për caktimin e fitimeve (për shpërndarjen e fitimeve, për caktimin e rezervave apo mosshpërndarjen e fitimeve të vitit ushtrimor apo dhe fitimeve të mbartura), do të merret në çdo rast në mbledhjen përkatëse të asamblese së ortakëve të shoqërisë, me miratimin në mënyrë unanime me 100% të të gjithë kuotave të shoqërisë.

Asambleja e ortakëve mund të vendosë që të shpërndahen shumat e fondeve të rezervuara duke treguar shprehimisht llojin e rezerves ku janë marrë.

Fitimet neto të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë si dhe shumat e fondeve të rezervuara, do të përdoren lirisht nga ortakët e saj. Ortakët do t'i disponojnë lirisht fitimet neto të shoqërisë si dhe shumat e fondeve të rezervuara, pas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, për shpërndarjen e tyre. Ortakët e shoqërisë nëpërmjet vullnetit të tyre të shprehur me shkrim, janë autoriteti i vetëm ligjor apo ekzekutiv, që vendos dhe vepron, në lidhje me caktimin e fitimeve neto të shoqërisë apo shumave të fondeve të rezervuara, për shpërndarjen ose jo të tyre, për investimin ose jo të tyre, si dhe për mënyrën e ndarjes së tyre midis ortakëve të shoqërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen.

Në çdo rast, dhe rast pas rasti, fitimet neto të shoqërisë apo shumat e fondeve të rezervuara, mund të shpërndahen midis ortakëve të saj, edhe në raportet e tjera që ortakët e shoqërisë, do të miratojnë në mënyrë unanime, me 100% të kotave të kapitalit të shoqërisë, pas analizave vjetore të aktivitetit tregtar dhe financiar të shoqërisë duke marrë në konsideratë edhe performancën e ortakëve në funksion të realizimit të fitimeve të shoqërisë, pavarësisht raportit të kuotave që ortakët kanë apo do të kenë në të ardhmen në shoqëri.

Ortakët e shoqërisë, nëpërmjet këtij statuti të shoqërisë, japin miratimin e tyre të plotë dhe të parevokueshëm, për mënyrën e ndarjes së fitimit neto të saj, të përcaktuar si më sipër në këtë nen, duke hequr dorë dhe njëkohësisht duke humbur çdo të drejtë të tashme dhe të ardhme, për të pretenduar ndryshe nga sa është përcaktuar në të.

Cdo ortak ka të drejtën e transferimit jashtë vendit të pjesës së fitimit duke zbatuar dispozitat ligjore për këtë transferim.

Neni 24

Në selinë e shoqërisë tregtare mbahet dokumentacioni i plotë i saj, mbahen protokollat e ndryshme, dokumentacioni i kontabilitetit ku mund të bëhet vetkontroll ose për t'ia vënë në dispozicion cdo organi kontrolli të ngarkuar me ligj. Dokumentat e shoqërisë duhet të njihen mire nga ortakët.

SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

Neni 25

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkak si në rastin e falimentimit, privimi i të drejtës për të ushtruar profesionin e tregtarit, forca madhore, raste lufte dhe cdo formë tjetër që nuk varet nga dëshira e Asamblese së ortakëve. Në cdo rast Asambleja vendos mbi mënyrën e likujdimit të shoqërisë duke caktuar një ose më shumë likujditorë.

Likujditorët dhe administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë derisa t'u dorëzohet personave përkatës fizik e juridik duke i dhënë përparësi likujdimit të detyrimit të shoqërisë ndaj të tretëve.

Mbas likujdimit të të gjithë detyrimeve ndaj të tretëve likujduesi i ndan kapitalet e mbetura mes ortakut/ortakëve përpjestimisht me kuotat që ata zoterojnë në kapitalin themelor.

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likujdimit dhe kryhen formalitetet e mbylljes Shoqëria ç' regjistrohet nga regjistri i tregtareve i QKB .

NDRYSHIMI I STATUTIT

Neni 26

Ky statut në përgjithësi, mund të ndryshohet me vendimin e asamblese së ortakëve, në përputhje me percaktimet e ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndërsa në lidhje me nenet 6, 7, 22, 23 dhe 26 të këtij statuti, do të ndryshohen vetëm me vendimin e asamblesë së ortakëve me miratimin në mënyrë unanime me 100% të të gjithë kuotave të shoqërie.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 27

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve nga Asambleja e Përgjithshme duke mbajtur parasysh kërkesat e ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Mosmarëveshjet që mund të lindin midis palëve në se nuk gjejnë zgjidhje me bisedime e mirëkuptim, do të zgjidhen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Cdo ndryshim e plotësim në statut nuk prek personalitetin juridik të shoqërisë tregtare “**Saranda Vacations**” sh.p.k.


Neni 28

Ky statut përpilohet në katër kopje të njëjta për t'ju shpërndarë organeve përkatëse.

Një kopje i mbetet shoqërisë tregtare “**Saranda Vacations**” sh.p.k., si pjesë e dokumentacionit themelor të shoqërisë.

Statuti hyn në fuqi ditën e shpalljes së tij dhe firmoset rregullisht nga ortakët themelues të shoqërisë.

Elbasan, më 18 Maj 2023.



ORTAKËT THEMELUS:

BALKAN PENINSULA ENTERPRISE

LEDJON AGALLIU

Signature of Ledjon Agalliu
Signature of Besvion Kalo